



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 50
Prishtinë, më 21 korrik 2010
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225
Mbledhja filloi në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë: Rustem Mustafa, Eqrem Kryeziu, Suzana Novoberdaliu, Basri Musmurati, Ismet Beqiri dhe Radmila Vujoviq - anëtarë të Komisionit.

Munguan: Lulzim Zeneli, Shkumbin Demaliaj dhe Zylfi Merxha - anëtarë të Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Antigona Ibraj, Blerina Pula dhe Nuredin Ibishi.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me datë **07.07.2010**
3. Shqyrtimi i Strategjisë së Sigurisë të Republikës së Kosovës
4. Të ndryshme

***Kryetari** konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me datë 07.07.2010

Procesverbali i datës 07.07.2010 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Strategjisë së Sigurisë të Republikës së Kosovës

Kryetari i Komisionit - Strategjia e Sigurisë së Republikës së Kosovës është shqyrtuar në Kuvend. Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri do të shqyrtojë Propozim Strategjinë e Sigurisë dhe Kuvendit ti paraqesë Raportin me rekomandime. Komisioni në mbledhjen e kaluar ka planifikuar organizimin e një Konference për shqyrtimin dhe dhënien e rekomandimeve e Strategjisë së Sigurisë, mirëpo Kryesia e Kuvendit ka ardhë në përfundim që të mos mbahen dëgjime publike dhe me shqyrtim të merren edhe dy komisionet tjera : Komisioni për mbikëqyrjen e FSK-së dhe për mbikëqyrjen e Agjencisë për Inteligjencë.

Ismet Beqiri – Edhe unë kam qenë pjesë e strategjisë në një mënyrë. Debatet apo dëgjimet publike janë qështje të ndijshme dhe mendoj që kjo nuk është e nevojshme. Strategjia është gjithëpërfshirëse dhe më tutje mund të plotësohet sepse nga dëgjimet shpesh nuk kemi ndonjë rezultat dhe nuk lejohet të ndërhyhet shumë në të. Mirëpo, mendoj se kjo strategji është dokument që kryesisht i përmban qështjet kryesore që do të duhet ti përmban.

Basri Musmurati - Unë mendoj se në kapitullin e tretë duhet ti kushtohet kujdes sundimit të ligjit, luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Institucionet që kanë obligim luftimin e këtyre qështjeve duhet të veprojnë më intensivisht.

Eqrem Kryeziu – Mendoj se në strategji është përdorur një fjalor korrekt dhe kjo strategji bëhet publike, sepse përmban parimet dhe qështjet e institucioneve bartëse. Unë nuk jam krejt i pakënaqur se qka është thënë rreth korrupsionit dhe krimit të organizuar në strategji. Në strategji thuhet se korrupsioni dëmton vlerat shoqrore dhe zbeh besimin ndaj institucioneve qeveritare. Kriza më e madhe në shoqëri është kur humb besimi në institucione, dhe në këtë dokument e ka paralajmëruar këtë. Përgjithësisht, mendoj se është një formë e të shkruarit korrekt dhe nuk është asgjë edhe nëse bëhet publike.

Radmilla Vujović – Ne jetojmë në një shoqëri ku ligjet janë në funksion, por ato ligje nuk zbatohen sa duhet. Unë mendoj se në strategji duhet të ceket edhe uzurpimi i pronave sepse në këtë dokument nuk është përmendur.

Suzana Novoberdaliu – Deshta të shtoj diqka në lidhje me korrupsionin. Unë mendoj se aty ku përmendet prokuroria duhet të përmendet edhe gjyqësia, sepse me ligjin për

gjykatat po shkohet ka plani për reformat gjuqësore. Gjithashtu do të ishte shumë me rëndësi që lëndët që kanë të bëjnë me korrupsion tu jipet prioritet që të tregohet se po luftohet kjo dukuri.

Ismet Beqiri – Kur flitet për krim të organizuar, ajo nënkuptohet të gjitha llojet dhe natyrat e krimit, pavarësisht a është uzurpim apo vrasje. Një ndër krimet më të mëdha që janë bërë në këtë shoqëri janë uzurpimet. Tek krimi i organizuar institucionet që e luftojnë apo që e kanë obligim luftimin e kanë parasysh se ndër krimet më serioze është uzurpimi qoftë i objekteve apo pronave.

Gjithashtu po e theksoj se strategjia nuk është dokument sekret sepse qysh tani ky dokument është publik dhe do të debatohet edhe në Kuvend.

Kryetari i Komisionit – Unë po përpiqem të nxjerr rekomandimet për këtë strategji.

E mira e kësaj strategjie është se me përkushtim të madh kanë punuar vendet përëndimore. Ajo qka dua të cek është se asnjë strategji e shteteve tjera të rajonit nuk është e nënshkruar parathënia nga Kryeministri dhe Presidenti. Në komision po e them se në asnjë strategji, në shtetet e rajonit nuk ka vend për nënshkrim. Rekomandimi i dytë për këtë strategji është të ceket ideologjia fetare apo ekstremizmi. Duhet të gjendet një terminologji mjaft e butë për këto qështje dhe të përfshihen si rekomandime të komisionit. Rreziku nga zyrtarët e lartë që po inkriminohen me grupe të ndryshme. Poashtu, kapacitetet financiare duhet të ruhen që zhvillimi ekonomik të jetë në nivelin më të lartë pra të ruhen investitorët e jashtëm.

Eqrem Kryeziu – Unë e përkrahi rekomandimin e juaj për parathënien e strategjisë, sepse ky dokument nuk lidhet me mandat.

Suzana Novoberdaliu – Kryetar, ju për këtë strategji keni qenë në rrjedha gjatë tërë kohës dhe i mbështes rekomandimet e juaja. Poashtu, pajtohem që në propozimet e komisionit duhet të përdoret terminologji më e butë.

Anëtarët e Komisionit si përfundim nxorren katër rekomandime për Strategjinë e Sigurisë së Republikës së Kosovës.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit – Ju njoftoj se ka ardhur një raport nga Institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me rastin e intervenimit policor në selinë e Lëvizjes Vetvendosja në Prishtinë për arrestimin e z. Albin Kurti. Këtë qështje e kemi debatuar në komision dhe ne kemi kërkuar nga Policia të dijmë se a kanë vepruar në bazë të regullave.

Sot është mbledhja e fundit të këtij sesiioni dhe desha të them se jam i kënaqur me gjithë punën që është bërë në komision. Më problem e shoh funksionalizimin e ligjeve se sa

prodhimin e ligjeve, dhe mendoj se kjo qështje ka me qenë sfidë në të ardhmen. Për këtë arsye kërkoj nga ju që të jemi më aktiv.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E hartoi:

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetari i Komisionit

Rrustem Mustafa